

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA E KOSOVËS PËR KËRKIMIN DHE DEKLARIMIN AGENCIJA E KOSOVËS PËR KËRKIMIN DHE DEKLARIMIN	
Prosp. / No. / Datë / Emri i autorit / Nr. i pajtimit	03/4432/12 14.12.12

REPUBLIKA E KOSOVËS

Shifra:0599,Nr.11537/2012

Gjykata komunale për kundërvajtje në Ferizaj, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Ramadan Baliu nga Ferizaj, për shkak të veprës kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të neneve 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën 27.11.2012, muarr këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Ramadan Brahim Baliu nga Ferizaj, rruga "Reqakut" pn. për vepër kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, sepse ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë përgjegjësin për kundërvajtjen, konform nenit 198 al.1 pika 2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të kësaj gjykate.

Nga një ekzemplarë i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

Arsyetimi

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë, bëri kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr. 01-2212/2012, të dt.04.06.2012, kundër të pandehurit për shkak të kundërvajtjes nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar dhe kërkoi që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse, morri në pyetje të pandehurin i cili në deklaratën e tij ka theksuar se unë kam bërë deklarim të pasurisë pranë AKK, por këtë e kam bërë me vonesë meqenëse në këtë kohë kam qenë në Shqipëri për një rast sëmundje të një anëtarit të familjes sime dhe si dëshmi për këtë deklarim të pasurisë gjykatës i ka afruar vërtetimin e AKK në Prishtinë nr.03/3402/12 të datës 06.04.2012.

Gjyqtari duke u bazuar në kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, në deklaratë ne të pandehurit dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se i pandehuri ka deklaruar pasurinë e tij në AKK me gjashtë ditë vonesë dhe me këtë mos veprim të tij me kohë nuk janë shkaktuar pasoja dhe mund të konsiderohet se ka përmbushur obligimin ligjor ngase edhe deklarimin e pasurisë e ka bërë para se të ngritet kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse nga ana e AKK në Prishtinë dhe nga kjo që u tha më lartë gjykata vlerëson se edhe pa ju shqiptuar dënim të pandehurit nuk pritet që ai në të ardhmen të kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjashme, andaj dhe bazuar në krejt këtë që u tha më lartë në mbështetje të nenit 11 dhe 198 al. 1 pika 2 të LK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sekretarja juridike
Kimete Bytyqi

Gjyqtari,

Imfi Seida

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankese në Gjykatën e Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi, nëpërmes të kësaj Gjykate, pa pagesë takse.